



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA E KOSOVES			
GOVERNMENT OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVES - VLADA E KOSOVES			
MINISTRIA E SHENDETESISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org. Jedinstvo Org. Unit	02	Art. Prolet Proyekt Version	05-4794
Nr.faqeve Br. stranica No. pages	-4-	Data: Datum: Date:	09/08/2023
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE PATOLOGJIKE

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE [IV]
NR. I NËNHAPAVE:[XIX]

APROVUAR:

Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



QËLLIMI	<p>QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË DEFINIMI I HAPAVE KONKRET TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PATOLOGJIKE NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE DHE INSTITUCIONE TJERA, KU GJENEROHEN MBETURINAT E TILLA ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETTIT TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR, SHËNDETTIT PUBLIK DHE TË MJEDISIT.</p> <p>KJO PSO ZBATOHET NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË CILAT GJENEROJNË MBETURINA PATOLOGJIKE.</p>
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. UA MPMH-NR. /2017 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE PATOLOGJIKE; 4. UA MMPH NR 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.
LISTA E SHKURTESAVE & PËRKUFIZIMET	<p>MMPHI – MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS</p> <p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE;</p> <p>UA - UDHËZIM ADMINISTRATIV;</p> <p>MBETURINA PATOLOGJIKE – MUND TË KONSIDEROHEN SI NJË NËNKATEGORI E MBETURINAVE INFEKTIVE, POR SHPESH KLASIFIKOHEN VEÇMAS (SIDOMOS KUR PËRDOREN METODA TË VEÇANTA TË TRAJTIMIT DHE ASGJËSIMIT). MBETURINAT PATOLOGJIKE PËRBËHEN NGA INDET, ORGANET, PJESËT E TRUPIT, GJAKU, FETUSET, LËNGJET E TRUPIT DHE MBETURINAT E TJERA NGA OPERACIONET DHE AUTOPSITË E PACIENTËVE ME SËMUNDJE INFEKTIVE. GJITHASHTU PËRFSHIHEN EDHE PJESE TË SHËNDETTSHME TË TRUPIT QË JANË HEQUR GJATË PROCEDURAVE MJEKËSORE OSE TË PRODHUARA GJATË HULUMTIMIT MJEKËSOR.</p>

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Paketimi i Mbeturinave Patologjike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat patologjike duhet të ndahen nga llojet e tjera të mbeturinave medicinale; 2. Paketimi i mbeturinave patologjike duhet të siguroj që të mos vie deri te rrjedhja dhe kundërmimi; 3. Mbeturinat patologjike hedhen në qese me ngjyrë të verdhë¹; 4. Qesja duhet të jetë qese plastike e fortë dhe rezistente ndaj rrjedhjeve; 5. Qesja duhet vendosur në kontejner të mbyllur me ngjyrë të verdhë; 6. Gjaku dhe/ose produktet e tij të përdorshme hedhen në qese me ngjyrë të verdhë.
[II]	Ruajtja e Mbeturinave Patologjike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat patologjike të vendosura në qese të verdhë, duhet të ruhen në temperaturë jo më të lartë se 8⁰C dhe nuk duhet të qëndrojnë më shumë se 5 ditë; 2. Në rast se mbeturinat patologjike qëndrojnë më shumë se 5 ditë, ato duhet futur në ngrirje të thellë, maksimum një vit deri në trajtimin e tyre; 3. Nëse nuk ekziston vendi i ruajtjes me temperaturat e lartpërmendura, mbeturinat nuk duhet të qëndrojnë të pa trajtuara gjatë stinës së verës, jo më shumë se 48 orë, ndërsa gjatë stinës së dimrit, jo më shumë se 72 orë; 4. Vendi i ruajtjes duhet të mbahet i siguar, si dhe të jetë i mirëmbajtur rregullisht (pastrim, dezinfektim, etj.); 5. Në qese të verdhë, duhet të shkruhet data e vendosjes së tyre në vendin e ruajtjes/deponimit të përkohshëm; 6. Mbeturinat patologjike duhet të ruhen në dhoma frigorifer, deri në kohën e asgjësimit të tyre; 7. Dhoma ku ruhen mbeturinat patologjike, duhet të ketë në derë të vendosur shenjën biohazard.

¹Të gjitha mbeturinat që hudhen në qese me ngjyrë të verdhë duhet të asgjësohen në Incinerator përpos fetuset!

[III]	Transporti i Mbeturinave Patologjike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Para transportimit, duhet të sigurohet, që paketimi nuk është i dëmtuar, me qëllim të mos rrjedhjes dhe përhapjes së mbetjeve, kundërmimi dhe gazrave; 2. Gjatë transportimit të mbeturinave patologjike duhet, që paketimet të jenë të mbyllura dhe të etiketuara në mënyrë të dukshme, me mbishkrim ‘Mbeturina patologjike’; 3. Automjeti frigorifer që bën transportin e mbeturinave patologjike duhet të mirëmbahet (të pastrohet, dezinfektohet, etj.).
[IV]	Asgjësimi i Mbeturinave Patologjike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat patologjike asgjësohen në Incinerator; 2. Mënyrë tjetër e asgjësimit është groposja e mbeturinave patologjike në vend të veçantë; 3. Fetuset groposen në vend të veçantë.

Referenca:

1. *Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014.*